

## INTERVISTË ME ENVER DUGOLLIN

Prishtinë | Data: 4 mars, 2022

Kohëzgjatja: 91 minuta

Të pranishëm:

- Enver Dugolli (I intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Renea Begolli (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## **Pjesa e Parë**

**Anita Susuri:** Zotni Enver, nëse mundeni me u prezantu me na tregu datën e lindjes? Vending? Diçka për familjen e juaj, prejardhjen?

**Enver Dugolli:** Po, unë jam Enver Dugolli i lindun me 27.01.1963. Jam fëmiu i katërt, të thom, para meje dy motra edhe ni vlla më pastaj edhe vllazër tjerë. Gjithsej jemi pesë vllazër dhe katër motra.

**Anita Susuri:** Ku keni jetu si fëmi?

**Enver Dugolli:** Po. Në fshatin Nekovc, ni fshat osht' në komunën e Drenasit, ish Gllgovc osht' qujtë përpara. Osht' ni fshat relativisht i madh, shkolla fillore osht' në fshat. Shkolla Fillore, "Bajram Curri", Nekovc. Aty edhe e kom kry shkollën fillore. Prindërit e mi, babai ka qenë... fillimisht ka qenë arsimtar, mësus edhe ka punu 14 vite si mësus. Më pastaj ka kalu në ni koperativë bujqësore në administratë. Gjithashtu ka qenë edhe rapsod i njohur dhe e ka përjetu edhe Luftën e Dytë Botërore. Ka qenë... më pastaj pas lufte e ka kry ni kurs pedagogjik, për shkak që klasën katër klasëshe e ka kry në ish Jugosllavi, atëherë në atë kohë ka qenë ndër të rralltë që e ka kry. Më pastaj ka shfrytëzu mundësitë edhe ofrimin që njerëzit që kanë pasë arsimim fillestar i kanë kry edhe kurset pedagogjike dhe ka punu si arsimtar, si mësus. Ka punu si mësus në fshatin e lindjes Nekovc, më pastaj edhe në Komoran, edhe në Shalë, Sodllarë i thojnë.

**Anita Susuri:** E për babën e juaj, më falni se po ju ndërpres, thatë për Luftën e Dytë Botërore, a osht' rreshtu, a ka qenë në ushtri apo vetëm e ka përjetu luftën?

**Enver Dugolli:** Fillimisht ka qenë, në bazë të asaj që na ka tregu, ka qenë për pak kohë i rreshtum me atë... gjatë pushtimit të Gjermanisë që e ka ba këtu. Në atë kohë që osht' njoftë si Shqipnia e Madhe që i kanë thanë. Ai ka qenë nja dy-tre muj në kuadër të asaj brigadës SS gjermane. Më pastaj osht' largu prej asaj brigade dhe ka shku në shtëpi. Pasi ka përfundu lufta ka qenë ni kohë si Sekretar i Rinisë për atë vend, si njeri që ka qenë i shkollum. Pas disa aksioneve që i ka marrë UDB në atë kohë kundër disa njerëzve që kanë bo rezistencë edhe me ni moment që babai nuk ka pranu të gjujnë, apo në ni rrethim që ka ndodhë i ka leju të ikin prej rrethimit. Dhe si rezultat i saj, më pastaj e kanë marrë në pytje dhe e

kanë përjashtu edhe prej Partisë, sepse osht' konstatu që ky me vetëdije i ka leju të dalin nga rrethimi. Nuk ka vepru sipas udhëzimeve që i kanë marrë edhe e kanë largu prej Partisë.

Pastaj ka qenë i shënjestrum dhe pas 14 vitesh si mësues e kanë largu prej të qenit mësues dhe ka shku me ni kooperativë bujqësore në Komoran. Aty ka vazhdu deri në penzion edhe në penzion të parakohshem për shkak të rrethanave që janë kriju, pas burgosjes time në vitin 1981 dhe si masë ndëshkuese për shkak timin e kanë penzionu. E kanë detyru të penzionohet para kohe, me nifarë forme e kanë largu prej punës. Nana ime është amvise edhe e veçanta e fëminisë sime osht' se unë jam rritë me ni familje të madhe, po me plot dashni edhe plot respekt për njani-tjetrin.

Asniherë në jetën time nuk kom dëgju prindërit e mi të fjaloseshin apo të kenë ndonjë problem. Siç mund të kishin ca moshatar të mi, sepse koha në cilen jam rritë ka qenë edhe fshati, domethonë rural e që i ka karakterizu raportet shoqërore që kanë mbizotëru në atë kohë kanë qenë goxha primitive. Mirëpo, në fshatin, në familjen time këtë asnjëherë s'e kam vërtetë. Edhe nga fakti se babai edhe nëna i kanë thy ca tabu në atë kohë edhe janë, janë martu me dashni dhe pa ato ritet apo traditat familjare që osht' dashtë me shkues, me shku me dërgu msit, me lyp, sepse e kanë dashtë njani tjetrin. Dhe me nifarë forme ka qenë, nana ime ka qenë që ka bo revolucion, e ka thy tabunë edhe ka marrë babain tim që ka qenë n'atë kohë mësues pa lejen e babait, pa lejen e prindërve të saj.

Kështu që, me ni kohë bukur të gjatë nuk, edhe nuk e kem ndi atë afërsinë e dajve për shkak se nuk kanë pasë raporte të mira për shkak të hidhërimit që kanë vazhdu ta mbajnë ni kohë të gjatë. Edhe pse, ne ishim fëmi edhe kishim lindë me ni familje që nuk e dinim, sepse fëmiu nuk e dinte çka ka ndodhë me prindërit e si janë martu. Mirëpo, ma vonë e kemi kuptu se arsyeja pse ne nuk kemi shku te dajtë ishte fakti se ata mbanin ende atë mërinë, atë hidhërimin që nana kishte... ishte martu me babain tim, Adilin, ish martu pa lejën e prindërve.

Shkollën fillore e kom kry në fshat, në Nekovc, shkolla fillore "Bajram Curri". Dhe aty në fshat më kujtohet që atë rrugën, që më pastaj në shkollë të mesme e kam vazhdu edhe kam fillu të orientohem kah ni rrugë krejtësisht e veçantë nga moshatarët e mi edhe bashkëmoshatarët e mi. Fillet i ka qysh në shkollën fillore, sepse me ka tërheqë edhe kureshtja që të mësoj ma shumë nga historia, ma shumë nga e kaluara e shqiptarëve, padrejtësitë që i ishin bërë shqiptarëve edhe këtë e dëgjoja në shtëpi nga babai. Po, në shkollë e dëgjoja nga arsimtari që e kisha n'atë kohë, Gani Syla, ish i burgosun që më pastaj u burgos në vitin 1979.

Mirëpo, ai ka qenë burimi im i frymëzimit, dhe si të thom, mësuesi që ka mbetë mësuesi i përjetshëm i veprimtarisë sime. Sepse fillet e para të atdhedashurisë nga, përveç familjes, i kam marrë nga arsimtari Gani Syla, mësusi Gani Syla, i cili tani veç osht' i ndjerë, ka ndrru jetë, ka vdekë. Por, gjithmonë e kam në kujtim dhe e mbaj në kujtim, sepse ai ka qenë nismëtari i rrugës time që më pastaj edhe kam vazhdu. Shkollën e mesme në Glllogovc kam fillu pas mbarimit të shkollës fillore dhe në vitin 1981

organizojmë demonstratat e vitit 1981 në Glllogvc, dhe vihem ashtu në ballë të tyre, të demonstratave duke lexu ni apel për demonstrata.

Une kam pasë ni fëmijëri të hershme po edhe ni pjekuri ma të hershme për shkak të interesimit tim edhe të angazhimit në nifarë forme edhe në grupin ilegal të asaj kohe, grupi Marksist-Leninist i Kosovës. I cili ish grup i organizum, grup atdhetar, por që funksiononte në treshe. Domethonë, ni i organizonte dy dhe kështu secili i organizonte pastaj nga dy e që quhej treshe, domethonë celula tre. Unë isha i organizum në atë kohë në vitin 1981 dhe...

**Anita Susuri:** E qysh keni depërtu në atë grup? Prej shoqnisë apo...

**Enver Dugolli:** Prej shoqnisë. Pasi Gani Sylja ra në burg, mësusi Gani Sylja ra në burg si i organizum në vitin 1979. Mua në nifarë forme burgosja e tij më ndikoi shumë. Ndikoi shumë edhe emocionalisht, por edhe ndikoi që me nifarë forme mungesën e mësuesit. Kur e dija për çka osht' burgosë ta kompenzoj me angazhim diku. Dhe kështu ni shok i asaj kohe që kishte qenë i organizum, më pastaj kam marrë vesh që ai kishte qenë i organizum nga dikush tjetër. Por, për grupin që bana fjalë më antarëson mu në grup në atë treshen që thashë edhe kam qenë, domethonë '81-shin kam qenë pjesë e grupit Marksist-Leninist të asaj kohe. I angazhum domethonë nga Milaim Zeka. Milaim Zeka ka qenë ai personi që më ka anëtarësu.

Mirëpo, në demonstratat e vitit 1981 edhe pse ishim të organizum, flisnim do të ishte mirë që të organizonim, se demonstratat shpërthyn në të gjithë Kosovën. Prisnim disi ndonjë informacion apo ndonjë shtyrje nga organizata. Dhe në pritje e sipër me 2 prill 1981, paralelet e ndara që ishin të shkollës së mesme në Glllogvc, ishin paralelet e ndara në Çikatovë, ni fshat aty afër Glllogvcit. Vjen në pushim të gjatë, vjen ni, ni... qarkullon ni letër, ni letër e cila ishte shumëfishu, ishte shumëzë edhe qarkullon nëpër nxanës. Edhe mu më bjen në dorë ajo letër. Ishte thirrje për demonstrata. Thirrja bëhej për orën 12:00, ishte ditë tregu, ishte ditë e ejte, dita e tregut ishte në Glllogvc.

Meqë ishte pushimi i gjatë e marr atë letër dhe automatikisht filloj të mendoj, "Jo në 12:00, por duhet me fillu tash". Po ju thom dy-tre shokëve e shoqeve që kisha afër, se e lexum letrën edhe... arsyeja ishte se unë mendova që po ta lëmë për orën 12:00 do të dështon. Shkaku ishte se milicia, policia e asaj kohe fillunë, ishin alarmu edhe fillunë të vinin vërdallë shkollës. Por ishte edhe rreziku tjetër që profesorët nuk i lejonin pastaj [nxënësit], po të futeshin nëpër klasë, nuk do t'i lejonin nxënësit që të dilnin. Dhe thashë, "Po fillojmë tash". Iniciativa ime që të fillonin jo në 12:00, se dyshoja që në 12:00 mund të organizoheshim, por të fillonim atëherë menjëherë posa e morëm letrën.

E marr këtë iniciativë edhe dalim nga aty ni grup i madh shokë e shoqesh edhe shkojmë në qendër ku ishte në Glllogvc, qendra e shkollës së mesme. Sepse ishin vitet e para tash aty edhe pritej në ora 12:00 deri në 13:00, pritej që të vinin edhe ndrrimet e tjera të pasditës. Arrimë në momentin që ishte ende pushimi i gjatë, në mes orëve. Dhe shkojmë, ata na shohin që po vijmë me gjasë edhe aty kanë

qarkullu këto letrat, qato pamfletet, qato thirrjet për demonstrata, por jo në shumicë. Dhe krijohet nifarë tollovie aty. Për të sqaru se çka po ndodhë unë marrë iniciativë vullnetare pa më ngarku kërkush. Kërkush nuk më ka ngarku që unë të hyp përmbi ni automjet që ishte i parkum aty për të tërheqë vëmendjen e nxanësve dhe të profesorëve dhe filloj me lexu thirrjen për demonstrata.

E përfundoj thirrjen për demonstrata me parullat që ishin, “Kosova Republikë!” “Republikë, Kushtetutë. Ja me hatër, ja me luftë!” “Trepça punon, Beogradi ndërton!” ishin, “Jemi shqiptarë, nuk jemi jugosllavë!” sepse ishte shumë me rëndësi edhe kjo. Në atë kohë bëhej propagandë e madhe që të na ndalnin etninë shqiptare, të na ndalnin, dhe të krjijojnë një ide fallco se ne jemi jugosllavë dhe të synojmë me atë që të shuhej ndjenja etnike e njerëzve dhe ajo ngrehina Jugosllavi mëtohej që të depërtonte sa ma thellë te njerëzit. Prandaj, doli edhe parulla, “Jemi shqiptarë, nuk jemi jugosllavë”. Se patën fillu n’atë kohë goxha njerëz shënoheshin jugosllavë në ato çertifikatat, ato regjistrimet që bëheshin, regjistroheshin si jugosllavë.

Kishte, domethonë, “Rrnoftë Shqipnia!” Domethonë, ishin parulla që lexoheshin edhe brohoriteshin, i lexoja dhe brohoritshin nxënësit. Kishte edhe parulla tjera, “Lironi shokët nga burgu”. Aty ishin, kishin ra në burg Gani Sylja, kishin ra edhe grupe tjera të organizuara dhe nga aty boj thirrje që të marrin flamujt, flamurin kombëtar edhe të dalmi rrugëve të qytezës, rrugëve të Drenasit të Glllogovcit. Pati një rezistencë nga drejtori, jo drejtori, por zëvendës drejtori, sepse ai ishte... si duket ishte aty për momentin dhe ka qenë pak ma i ashpër ai. Nuk donte t’i hapte dyrtë e shkollës për t’i marrë flamujt.

E paralajmëroj, i tham, “Ne duam veç flamujt t’i marrim edhe të dalim. Na e hap derën ose e demolojmë derën”, e thyem. Nuk e hapi e demolum derën. Hym dhunshëm ni grup nxanësish i marrim flamujt. Flamurin e Jugosllavisë e shkym, e shkyjtën disa shokë e gjuan për toke. Gjithashtu edhe emrin e shkollës që ishte, gjimnazi “Marshall Tito”, edhe ai emër u hoq, u demolu pllaka që shkruante “Marshall Tito”, dhe fillun të brohorasin edhe demostruesit e shkolla e mesme “Skënderbeu”, dhe domethonë e gjitha ndodhi aty. Më pastaj morëm rrugë për qytezë, për Drenas. Glllogovc, në atë kohë quhej.

Drejtori që ishte... më pastaj erdhi drejtori ishte Ymer Elshani, poeti i ndjerë tani që osht’. Dhe ai e mori situatën në dorë dhe nifarë forme i urdhëroi profesorët që në emër të kujdestarisë të vijnë përreth nxënësve që ish kolonë e madhe, tashma kishin dalë gati të gjithë nxënësit, që në emër të kujdestarisë edhe ata të ishin përskej nesh. Ajo ishte ni inkurajim edhe për ne për shkak se profesorët tani u bën s’bashku me nxënës. Pa çka se ata kishin gjoja se ishin në kujdestari dhe për t’u kujdesë që të mos eskalon më tutje situata.

Në... Filluan, kur shkuam në qytet fillunë që i patëm përballjen e parë me polici, me milicinë e asaj kohe. Na urdhërun që të shpërndahehim edhe natyrisht që ne nuk e pranum atë ultimatum dhe fillunë kacafytjen e parë me nifarë forme. Ne gjuanim me gurë, ata tentonin që të na shpërndanin me gaz lotsjellës. Dhe fillun nga aty të na ndajnë grupe pak ma të vogla. Mirëpo, ne vazhdimisht silleshim

rrotull, por asnjëherë nuk shpërndahehim të gjithë. Dhe kjo vazhdoi, kjo msymje e tyre dhe kjo farë, ky aksion i tyre derisa erdhën edhe nxënësit e pasditës. Kur erdhën edhe nxënësit e pasditës u bo turma tash shumë ma e madhe.

Kur u bo turma shumë ma e madhe, policia hoqi dorë tash nga ndjekja se ish turmë e madhe. Shto këtu pastaj edhe kur iu futëm qytetit për të shku te “Feronikeli” ishte ditë tregu edhe na u bashkangjitën edhe shumë fshatarë e njerëz punëtorë që kishin dalë për treg edhe na u bashkangjitën me ne u bashkangjitën. Më kujtohet se për t’ marrë sa ma shumë njerëz ne brohoritshim, “Kush nuk vjen osht’ tradhëtar”, dhe kjo me nifarë forme pak sikur i inkurajonte njerëzit që t’ mos rrijnë indiferent. U bo ni demonstratë shumë e madhe edhe vazhdum deri te “Feronikli”, dhe atje me synim që t’i marrim edhe punëtortë.

Kur kemi shku te “Feronikli”, aty veç kanë arritë njësia speciale që ishte nisë prej Prishtinës edhe njësia speciale që kish ardhë prej Nishit. Aty kanë fillu me gjujtë s’pari me gaz lotsjellës edhe me armë, me armë zjarri. Ka pasë të plagosur, mirëpo prapë se prapë nuk arritën që ta shpërndajnë demonstratën. Ishte demonstrata ma e madhe që kishte ndodhë najherë në Drenicë. Ni element shumë me rëndësi që vlen m’u theksu osht’ që ishte ndër demonstratat thuajse ma masovike, po edhe që ndodhi diçka e jashtëzakonshme.

Me nifarë forme e morëm edhe stacionin e policisë. Si e morëm? Ngaqë u bëmë shumë e ne dyshonim që i kanë burgosë disa shokë tanë, e rrethum stacionin e policisë dhe kërkonim që t’i lironin. Ata thonin, “Nuk i kemi”, e ne nuk u besonim. Kështu që, u formu ni grup i dy-tre vetë. Ndër ta ka qenë edhe Elmie Plakaj në atë delegacion edhe hynëm në të gjitha zyret e stacionit të policisë i detyrum që të hapen të të kontrollojmë mos kanë mshef diçka aty. Me nifarë forme ishte ni lloj pushtimi i stacionit të policisë që nuk kishte ndodhë më parë në demonstrata.

Mos të harroj se atë apelin që e lexoj unë, atë thirrjen që e lexoj nuk e kam ditë kush e ka shkru. Kur burgosem mas dy dite më arrestojnë edhe fillojnë edhe torturat edhe marrja në pyetje, po asniherë unë nuk e di kush e ka shkru. Me nifarë forme, fillimisht e marr përgjegjësinë. Thom, “Unë e kam shkru”. Por, ata e dinin fort mirë që s’e kam shkru, sepse ajo letër ishte gjithandej...

**Anita Susuri:** A osht’ e njejta letër që në shkollë e keni marrë?

**Enver Dugolli:** Po, po, në shkollë. Dhe nuk e dija une se kush e ka shkru ata. Edhe ata e kam mësu veç kur, masi jam dënu, edhe ata shumë rastësisht e kam mësu. Isha në, masi u dënova isha n’burg në Prishtinë me Bajram Kosumin, ishte në hetuesi, ishte në fazën e hetimeve gati para procesit gjyqësor. Dhe ni ditë e marrin në mramje, në mramje e marrin edhe vonohet shumë deri kah mëngjesi nuk e bijnë. Sa herë e merrnin që ishte në hetuesi vinte i torturum. Atë ditë u vonu shumë. Kur vjen po tregon tha kështu kështu e kishin marrë e kishin dërgu deri në kufi me Shqipëri.

Në atë kohë që u përhap lajmi që disa të burgosur politik po i çojnë deri në Shqipëri edhe gjoja se kanë dashtë me ikë, i ekzekutonin. Edhe këtë formë të presionit e bënë. Edhe këta e kishin bo ndaj Bajramit, mirëpo fatbardhësisht nuk e kanë ekzekutu po veç si lloj frike. Kah vijnë knej e pysin njerëzit e UDB-së të Sigurimit Shtetërorë, “Me kë je në dhomë?” Ky i tregon edhe ndër tjera ma përmend emrin mu edhe tash aty ni serb edhe ni shqiptar. Ai shqiptari ni Lutfi Ajazi, ni punëtor i UDB-së, ai mu më njipte edhe ai serbi thotë, “Kush osht’ ky Enver Dugolli?” E ky ia përkthen, i thotë serbisht ai që e ka lexu apelin e Halil Kuliqit. Edhe tek kur erdh po m’thotë, “Kush osht’ Halil Kuliqi?” Po më thotë Bajrami, thashë, “Nuk e di kush osht’”, tha, “Po ni letër që e ke lexu ti”, thashë, “S’e di kush e ka shkru hiç”, tha, “Halil Kuliqi e kish shkru”. Edhe Halili i burgosun, por unë nuk e kam njoftë. Ka qenë arsimtar ai edhe tek atëherë e kam mësu, domethonë [aty] e kam mësu të vërtetën e asaj letrës.

## Pjesa e Dytë

**Anita Susuri:** Po më intereson qysh ka ndodhë arrestimi? A kanë ardhë n’shpi apo qysh ju kanë gjetë juve?

**Enver Dugolli:** Po, në shpi kanë ardhë. Në shpi për shkak se unë tanimë veç isha ekspozu në demonstratë, isha ekspozu, kisha dalë, kisha hypë mbi veturë, kisha lexu, e kisha lexu apelin për demonstratë, thirrjen për demonstratë. Nifarë forme demonstrata identifikohesh me mu si prijës edhe medomos unë e pritsha, e pritsha që kanë me ardhë për me më arrestu. Por, në asnjë variant nuk e shisha të arsyeshme që të largohesh, të iksha, ta lshojsha vendin. Edhe ni arsye tjetër ishte për shkak se menjsh, meqë në demonstratë ishte vllau madh, ishte pjesëmarrës thoja, mendoja, që po të iksha unë do ta merrnin atë. Kështu që, unë me vetëdije e pranoja që do t’më arrestonin, por nuk hamendësha a të rri, a të largohem.

Kështu që, mas dy dite, domethonë me 4, me 4 prill 1981 erdhën në shtëpi edhe më arrestun. Edhe me 3-tin kishim, provonim edhe me 3 mars ne provum prapë të organizojmë demonstratat po ishte e pamundur për shkak se kishte shtet-rrethim. Me nifarë forme Drenasi, Gllgovci ishte plotësisht i bllokum, nuk kishte mundësi asesi që të futeshim në brendësi të qytetit.

**Anita Susuri:** Pastaj juve ju kanë sjellë thatë në burgun e Prishtinës?

**Enver Dugolli:** Po.

**Anita Susuri:** Qysh ka qenë aty?

**Enver Dugolli:** Në burgun e Prishtinës kur më dërgojnë prej, se më mbajnë dy ditë më mbajnë në Drenas ka pasë ni keqtrajtim të jashtëzakonshëm edhe pse isha shumë i ri, 18 vjeç isha. Nuk mbahet mend ni sjellje aq arrogante, aq e vrazhdë, aq brutale e policëve edhe pse ishin shqiptarë krejt. Ni

pjesë e tyre ishin, solidarizoheshin me ne edhe vuanin me nifare forme atë sjellje të kolegëve të tyre, por ishin krejt pafuqishëm që ta ndrronin atë situatë. Kështu që, nuk them që ishin të gjithë, ishin ma shumë se gjysa ishin njerëz t'mirë që e donin venin, edhe pse ishin me uniformë të milicisë të asokohe. Por, ni pjesë ishin shumë të vrazhdë, ishin shumë agresivë, brutal edhe kanë... osht' njollë shumë e keqe për ta, por edhe për Drenasin.

Për shkak se më pastaj kur isha n'burg edhe jam taku edhe me njerëz tjerë që kanë përjetu edhe kanë organizu demonstrata. Kur ju tregoja çka ka ndodhë në Drenas që ishte faktikisht etnikisht e pastërt, nuk kishte asni serb në Glllogovc, ata habiteshin. Habiteshin qysh ka mundësi. Për shembull, në Lipjan që gjysma ishin serbë e gjysma shqiptarë, aty nuk ka ndodhë ni trajtim i tillë. E në disa vende tjera që ka pasë... me gjasë nëpër vende tjera t'u qenë të ndamë me etni kanë qenë ma shumë të fokusum që ta rujnë atë unin e vet si shqiptarë e mos t'i bëjnë disa sjellje që faktikisht kanë qenë të panevojshme. Për shkak se ajo shfryrja e tyre brutale ndaj nxënësve, ndaj rinisë, pa kurfarë arsye thjeshtë një shfryrje e mllefut pse kishim demostru, ishte totalisht e papranueshme.

Në gjyq dalim edhe na bëjnë një grup, një grup prej njëmbëdhjetë vetësh. Grupin e bojnë për shkak si duket që me na dënu ma shumë. Unë nuk i njihja gati thujse asnjë në grup, krejt ishin njerëz që kishin marrë pjesë në demonstrata, po nuk kisha lidhje me ta. Edhe pse të gjitha ato veprime që i kisha bo ishin publike edhe unë nuk i fshehja edhe i pranoja, "Thjeshtë kom dalë me demostru për Kosovën Republikë dhe nuk pendohem për këtë". Bile m'kujtohet ni moment në burg para se t'na dënojnë, erdhi gjyqtari hetues, me të thanë të drejtën unë isha i ri 18 vjeç edhe nuk e kisha fare idenë çka osht' gjyqtari hetues e çka osht' gjyqtari apo prokurori tjetër, fare s'më interesonin këto.

U prezantu erdh në burg për me marrë deklaratën. Ndër tjera kur e përfundova deklaratën tha, "A pendohesh për këto që ke bo?" Thashë, "Çka?" Mendja e tij që nuk po e kuptoj pytjen. Tha, "A i bjen pishmon?" Thashë, "Jo, jo, une të kuptoj për çka po folë ti. Por, për çka une me u pendu?" Thashë, "Pse m'i ra pishmon?" Tha, "Po, për çka ke bo". Thashë, "Po une kom bo mirë", thashë, thashë, "unë kom kërkru Kosova Republikë", thashë, "Kosova Republikë osht' mirë edhe për ty. A nuk je ti për Kosovën Republikë?" I shkoj buza në gaz, qeshi edhe m'u kthy, "Unë jam me t'pytë ty, jo ti mu". Ka qenë ni gjygtar hetues, Ymer Rosaj e ka pasë emrin. Nuk e di tash ku osht' e çka bon, por e di që këtë komunikim e kemi pasë.

Pastaj në proces gjyqësor dalim edhe pas gjithë atyre pyetjeve, asaj procedurës krejt, të thom, formale, se siç dukej ato dënimet veç ishin caktu. Sjellin shumë dëshmitarë edhe për çka me sjellë ata dëshmitarë për me tregu që kam qenë në ballë të demonstratave, kam lexu këtë [apelin]. Edhe ju thashë, "Çka po i mundoni këta dëshmitarë, unë vet po e pranoj. S'keni nevojë ju të t'ma dëshmoni me asgjë, vet po e pranoj që e kam lexu letrën, apelin për demonstrata. Kam dalë në demonstrata, nuk pendohem". Edhe në fjalën përfundimtare u kriju nifare rrethane pak jo e kandshme për mu, për shkak se si duket në atë grupin që na kishin bo prej njëmbëdhjetë vetë i kishin frikësu një pjesë goxha të



madhe të tyne edhe fillunë të deklaroheshin që nuk e kanë ditë çka u bo, “Na kanë shti me zor”, e kështu me radhë.

Fillova m’u ndi keq edhe para se me përfundu atë procesin e deklarimit edhe me shpallë dënimin. Unë e ngriti dorën edhe thom, “Po du edhe fjalën përfundimtare”. Tha, “Po, u kry”, ai gjyqtari, Isak Nishevcu ka qenë. Thashë, “Jo, s’u kryenë se kam të drejtë fjalën përfundimtare”, “Hajt”, tha, “çka ki me thanë?” Thashë, “Veç po du”, thashë, “të evidentohet kjo se të gjitha veprimet që i kam marrë i kam marrë me vetëdije. Askush s’më ka shti me zor, askush s’më ka detyru. Edhe ndihem fort mirë e shumë i kënaqun që qikjo punë e imja, sado pak të ndikon që të realizohet Kosova Republikë, kërkesa për Kosovën Republikë”. Nifarë forme u prenë, nuk e pritën ata atë deklaratë se unë isha ma i riu. “Ulu”, tha edhe nifarë forme, edhe sot e kam parasysh atë farë situatën qysh u kriju. Prokurorja u konë nifarë, Nijazi Burgideva ka qenë edhe do syza të trasha po kqyrë kështu {shpjegon me duar bën sikur i ulë syzet}. U habit zaherë prej përgjigjes që e dhashë edhe moshës time edhe [më tha], “Ulu!” U ula.

Na shqiptun dënimet mas dhetë minutave masi që dolën, [ata] erdhën. Më dënum njëmbëdhjetë vjet, domethonë katër ne të atij grupit u dënum me njëmbëdhjetë vjet. Më pastaj, po nuk më bënte fare përshtypje, të them të drejtën, isha i ri isha me nifarë forme i përgatitun që kanë me më dënu. Por, kur i shihje gjithë ata njerëz nëpër burgje, gjithë ata profesorë, studenta, rini, me nifarë forme nuk kish vend për mërzë aty. Thjeshtë ndihesha shumë krenar që n’atë moshë isha në gjendje që të përballësha me ato pasoja. Më pastaj shkalla e dytë e Gjyqit Suprem, si duket aty edhe prokurori kërkon që të zbutet dënimi për mu, për shkak se isha nifarë forme 18 vjeçar po dënohesh njëmbëdhjet vjet. Edhe ma zbusin dënimin në gjashtë vite. Gjashtë vite. Më pastaj, gjashtë vite i mbaj deri në fund.

**Anita Susuri:** Të gjitha në burgun e Prishtinës?

**Enver Dugolli:** Jo, jo, më transferojnë në burg të Pejës. Prej burgut të Pejës në burgun e Nishit, dhe ato i përfundoj pastaj në burgun e Nishit.

**Anita Susuri:** A mundeni me na tregu qit’ përvojë që e keni pasë nëpër këto burgje? E di që secili burg i ka do rregulla të veta, i ka do... nëse mundeni me na tregu ma shumë për përjetimin.

**Enver Dugolli:** Po, burgu si burg thujase osht’ në parim i njejtë. Kufizim i lëvizjes edhe privim nga e drejta për të qenë i lirë, por dallojnë më pas burgjet. Ka burgje që i kanë kushtet pak ma t’mira, disa i kishin ma të kqija, e disa shumë ma të kqija. Por dallon pastaj edhe ajo ekipa aty që osht’ e gardianëve, e udhëheqësve. Disa sillëshin pak ma butë, për shembull në burgun e Pejës aty sa i përket gardianëve e udhëheqësve të burgut veç e dije që je në burg, për shkak se ata sillëshin shumë miqësor me ne. Ka qenë vllau i Ekrem Kryeziut drejtor burgu, Fuad Kryeziu, ni burrë shumë i mirë, drejtor burgu. Dhe ai nuk i lejonte që të ketë sjellje jo të mira ndaj nesh, na respektonte shumë.

Mirëpo, këta nuk mund të them për burg të Prishtinës. Për shembull, në burg të Prishtinës gardianët ishin shumica ishin të egër, silleshin jo mirë. Ata, ishin pak që silleshin mirë, ishin shumë pak që silleshin mirë, sepse këtu kishte edhe gardianë serbë. Kishte ma shumë e si duket edhe ata pak të mirë që ishin nuk guxonin fort të ekspozoheshin, sepse neve na shpallën armik të shtetit. E kështu. Pastaj në burgun e Nishit atje kam qenë shumë kohë i izolim. Katër vite e gjysë kam qenë i izolim. Izolim thirrej ai pavijoni që nënkupton veç 20 minuta në ditë me dalë në oborr në shëtitje edhe mrena tanë kohën.

Mirëpo, në atë kohë, e kam shfrytëzu shumë atë kohë për me lexu. Kam lexu shumë. E kishim ni bibliotekë aty që në dy javtë na jepnin libra, katër vetë ishim në dhomë i merrshim katër libra. Secili nga ni libër dhe kështu them se koha që kam lexu ma së shumti osht' ajo kohë...

**Anita Susuri:** E në burgun e Nishit, a keni pasë të lejume me lexu libra në gjuhën shqipe?

**Enver Dugolli:** Po, për këtë në Nishë po flas, se në burg hetues nuk na lejonin.

**Anita Susuri:** E në burgun e Prishtinës e di që më doket qelitë kanë qenë të vogla shumë...

**Enver Dugolli:** Po.

**Anita Susuri:** Qysh kanë qenë qelitë?

**Enver Dugolli:** Qelitë kanë qenë të vogla. Kur më kanë sjellë prej Gllgovcit, ka qenë ni qeli në fillim po ka qenë pak ma e madhe edhe di se natën m'kanë sjellë aty. Kur jom futë aty, ka qenë, si me thanë, tmerr. Ka pasë shumë njerëz, të gjithë kanë qenë nifare forme të shtrimë për gjumë, po krejt dyshemeja ka qenë e nxanme. Nuk kanë pasë thujse vend as në krah të shtrihen, për shkak se ka qenë e mbushur krejt. Edhe aty diku kam qëndru, diku rreth shtatë-tetë ditë. Sepse i sillnin, s'kishin vende ku t'i lenin të burgosurit që arrestonin përditë. Ajo dhomë ka qenë e mbushur, mbi 30 veta kemi qenë aty, që osht' abnormale me mendu veç si hapësirë qysh i zenë 30 veta.

Po kushtet kanë qenë shumë të vështira, të kqija, pa WC brenda. Ka qenë ni kantë aty që edhe nevojat fiziologjike osht' dashtë aty t'i... erë ka qenë, lagështi, gjithçka keq. Më pastaj më patën dërgu në burg të Gjilanit, e kështu me radhë pastaj...

**Anita Susuri:** Sa kohë iu ka ra me qëndru në Prishtinë? Në burgun e Prishtinës?

**Enver Dugolli:** Po, në Prishtinë kam qëndru, kam qëndru dikund rreth tre muj - katër. Por, më pastaj, në burgun e dytë, osht' tjetër, prapë jom rikthy në Prishtinë.

**Anita Susuri:** A keni pasë të drejtë për vizita? Sigurt keni pasë, po qysh kanë qenë këto edhe sa ka qenë koha që keni mujtë me shfrytëzu për ni vizitë?

**Enver Dugolli:** Vizitat janë realizu me kërkesë të familjes, domethonë te gjyqtari hetues. E gjyqtari hetues apo i procedurës, qysh quhet tash, i ka dhanë leje se kush me ardhë me vizitu. Vizitat kanë qenë shumë të shkurta, dikund eventualisht dhetë minuta e ndonjëherë ndoshta edhe më pak. Përmes grilave, grilat kanë qenë shumë të shpeshtë që s'ke mujtë domethonë bash mirë me pa personin që ka ardhë, familjarin që ka ardhë me të vizitu. Pa kontakt fizik, veç ndërmjet, domethonë që osht' dëgju zani edhe osht' pa. Por, jo mirë, për shkak se grilat kanë qenë të shpeshtë.

**Anita Susuri:** Po më intereson për dhunën fizike, a ka qenë veç në fillim kjo apo vazhdimisht ka pasë dhunë?

**Enver Dugolli:** Në burg janë dy periudha. Janë dy periudha që shquhen për, domethonë për dhunë fizike. E para osht' ajo e hetuesisë, ajo osht' dhunë e paparashikume edhe në nifarë forme që osht' dhuna ma e tmerrshme që mund të zhvillohet osht' ajo dhuna e hetuesisë. Për shkak se ata në atë kohë je në duar, i burgosuri është në duar të një shërbimi sekret, siç ishte UDB-ja e cila e zhvillon komplet hetimin. Edhe pse, zyrtarisht prokuroria osht' ajo që i zhvillon hetimet. Mirëpo, atëherë nuk, atëherë po edhe ma vonë UDB-ja ka qenë ajo që e ka zhvillu komplet atë proces. Dhe për me nxerrë sa ma shumë informata, sa ma shumë informata akuzuese, ata përdornin dhunë. Aty ku dyshonin edhe aty ku menonin që ka çka të nxirret, hala ma shumë për me dekonspiru kështu, për me pranu vepra, për me pranu veprime që ishin bo që dyshonin. Pastaj që me nifarë forme të lidhnin me ato veprime.

Ajo periudhë osht', domethonë, osht' e tmerrshme, osht' histori në veti, e cila ato... marrja në pyetje zakonisht ndodhte në mramje. Në mramje kur gjithçka ishte e qetë e që nuk donin ata që të pengonin ato zyret e UDB-së që ishin në burgun e Prishtinës. Por, faza tjetër osht' pastaj deri në fund të burgut ajo me shkas, domethonë varësisht prej sjelljes së gardianëve edhe prej atyne momenteve që ata, disponimin kaniherë. Thjeshtë, kishte gardianë apo udhëheqës burgu që veç donin ndonjë ndëshkim me ta dhanë. Por, ato nuk përjashtoheshin edhe krejt kualifikoheshin si thymje e rendit shtëpiak.

**Anita Susuri:** Po më intereson pas periudhës të burgut, çka keni vazhdu pastaj? Me aktivitetin politik a keni vazhdu ende apo jeni, keni vazhdu me shkollën? Qysh ka vazhdu pastaj?

**Enver Dugolli:** Po, mas burgut të dytë, pasi që kom dalë prej burgut të Nishit në ni kohë kam pasë nifarë nevoje shumë të madhe që t'i gjindem familjes edhe të kontriboj pak te familja me punën time. Me sjellë të ardhura në familje, për shkak se ish dërmu ekonomikisht familja. Thashë ma herët që babai ka qenë në prag të penzionit, ka pasë edhe katër vite me dalë në penzion. Osht' detyru që... e kanë detyru që të largohet prej punës. E shoktë e punës janë mbledhë edhe ia kanë grumbullu m'i ble edhe katër vjet shtazh pune që ta ketë penzionin, se edhe pa penzion kanë synu me lanë. Kështu që, të vetmet të ardhura që ka pasë familja ka qenë ai penzion i prindit. Edhe shto këtu se familje shumë e madhe e shpenzime të mëdha. Nuk kishim toka bujqësore, nuk kishim tokë bujqësore. Të vetmen të ardhun e kishim atë penzion.

Harxhimet që shkakttoheshin për vizita që vinin ishin rëndesë shumë e madhe për buxhetin familjar. Kështu që, t'u e pa situatën e familjes edhe t'u qenë i vetëdijshëm që ata kishin vujtë shumë edhe ekonomikisht, obligohem nifarë forme, si moralisht që t'ua kthej familjes dhe të angazhohem edhe vet të punoj diçka. E puna që bëja ishin punë fizike, sepse nuk... ishte e pamundur që të inkuadrohesh diku me ndonjë vend pune. Isha armik i shtetit, isha i izolim, isha i përcjellun gjithkund. Kështu që, të vetmen punë që mund të bëja ishte puna fizike. Edhe aty u deshte që të shkoja larg, shumë larg, në Zagreb, në Slloveni, Ljublanë. Domethonë, ishin këto vendet që u dashke me shku me punu. Për shkak se ishte larg atje edhe t'u qenë vende ma të mëdha ndoshta nuk ishin edhe përcjelljet aq të rrepta.

Kështu që, ni kohë kam vazhdu kështu të punoj fizikisht edhe të sjellsha të ardhura për familjen. Më pastaj kthehem edhe në Kosovë. Fillova të mësoj zanatin e ndërtimtarisë, bëhem mjeshtër pa qenë kurrë mjeshtër edhe merrem edhe me ndërtimtari. Në ndërkohë pastaj e regjistroj edhe vazhdimin e shkollës të mesme kështu me korrespondencë. E përfundoj edhe shkollimin e mesëm, sepse pas viteve të '90-ta pastaj lirohet në nifarë forme kjo, ai presioni i madh që kishim prej sistemit. Në atë sistemin paralel të arsimit që u organizu m'u mundësu, sepse më parë as që flitej, nuk flitej se isha i dënum. Isha armik i shtetit edhe kjo gjë veçse erdhi më pastaj kur qytetartë, populli i Kosovës i tha nifarë forme jo masave të Serbisë që ndërmoi për suspendimin e autonomisë edhe ka qenë nifarë unifikimi i qytetarëve, i popullit shqiptarë, i shtresave të gjana popullore. Edhe arsimit filloi atëherë që të funksionoj nifarë forme, arsim paralel por që ishte gjithkund nëpër Kosovë.

**Anita Susuri:** A e regjistruat edhe fakultetin atëherë?

**Enver Dugolli:** Jo. Në atë kohë s'e kam regjistru fakultetin për shkak se thashë që ishte nifarë forme vendim i imi kështu që të kontriboja me financa për familjen. Ishim familje e madhe dhe nuk arrija dot që ta përballoja ni situatë të përkeqësime ekonomike, nifarë forme e ndjejsa si obligim. Në atë kohë pastaj njihem edhe me bashkëshorten tash që e kam, Sherifen, fillojmë të kalojmë me të edhe fejuhem.

**Anita Susuri:** A ka qenë problem për atë ose për familjen e saj ju që keni qenë në burg ose që jeni marrë me këto aktivitete politike?

**Enver Dugolli:** Shumë problem i madh ka qenë. Në kohën kur jam njoftë me ta ka qenë shumë problem, sepse ka qenë qajo periudha ma e vështirë e asaj kohe kur ende njerëzit shiqoheshin si armiq të shtetit. Dhe bash në atë kohë une takohem me shoqen time edhe ajo ka qenë ni familje e persekutime. Xhaxhi i saj ka qenë Fazli Grajçevci edhe ata si familje kështu kanë psu nga regjimi edhe i kanë njoftë mirë këto ndëshkime edhe këto izolime që ia ka bo shteti, por edhe shoqnia. Edhe pse kishte kundërshtime, prapë se prapë si duket dominoi, dominoi ajo ndjenja e dashurisë. Edhe kështu që nuk bëhej fjalë që të ktheheshim mrapa edhe të mos vendosnim ta bashkonim jetën edhe të kalojmë.

Kështu që, ishte ai momenti pastaj edhe që i fillimit të krijimit të familjes, u martum por gjithmonë në ato kushte shumë të randa edhe ekonomike, por edhe politike. Une thom kur njihem me shoqen ndër tjera dua që të sigurohem nga ajo që ta njoftoj se rruga ime osht' goxha sfidë edhe për të do të jetë për shkak se unë nuk hiqsha dorë edhe nga angazhimet politike. Domethonë, të angazhimeve patriotike që i kisha edhe politike. Edhe i them se ma e pakta që mundet me ndodhë është që të burgosem prapë e ndërsa mund edhe të vritem krejt. Por, ajo pranon edhe këto kushtet.

Në vitin 1997 ndodh ajo që i thom shumë vite përpara se edhe mund të burgosem. Kështu që, si rezultat i angazhimit tim pastaj që i vu kontaktet edhe me organizatën LKÇK, Lëvizjen për Çlirimin Kombëtar të Kosovës, si anëtar i saj. Detektohem apo zbulohem, nuk e di ende si. Por, para mëngjesit, me 27 janar 1997 para mëngjesit herët vijnë rrethohet komplet familja. Komplet shtëpitë si duket edhe lagjja...

**Anita Susuri:** Ju keni qenë në fshat ende?

**Enver Dugolli:** Po, në fshat. Në fshat kam qenë. Edhe më arrestojnë.

**Anita Susuri:** Po më intereson paraprakisht, cilat kanë qenë aktivitetet që i keni zhvillu në atë organizatë?

**Enver Dugolli:** Në atë organizatë kanë qenë aktivitetet, kanë qenë vetëdijësimi i qytetarëve, i popullit për organizim luftarak, për organizimin e luftës çlirimtare, që nënkupton ishte me agjitu. Me folë me njerëz, me i përgatitë njerëzit se e vetmja rrugë që ka mbetë për m'u çliru osht' rruga e armatosur e luftës çlirimtare. Sepse une e pata nda bukur herët mendimin se nuk çlirohet vendi me metoda pacifiste. M'u dokshin në fillim ishte nifare forme eufori ajo edhe krejt populli u bashku rreth ni opsioni për shtetin e Kosovës, për Republikën e Kosovës. Por, me kalimin e kohës u pa se nuk jepte rezultat, domethonë metodat pecisifte nuk jepshin rezultat. Ishte, ishte nevoja që të ketë ni rezistencë aktive. E mbi të gjitha unë mendoja që rruga e vetme që kishte mbetë, ishte rruga e luftës çlirimtare.

Krejt angazhimi im, fokusi im edhe i organizatës ishte që të mobilizonim njerëz, të kontaktonim njerëz, të vetëdijësonim njerëz se duhet të përgatiteshim për të luftu për vendin, për shkak se nuk kishte rrugë tjetër. Në kuadër të aktiviteteve shpërndanim edhe parulla, shpërndanim edhe afishe, shpërndanim edhe gazeta që ishin n'atë kohë edhe interesoheshim për vija të furnizimit për armatim, për grumbullim të mjeteve që do t'na duheshin gjatë luftës. Mirëpo, mua më zuri, më zuri ende pa e bo atë hapin konkret që të organizoheshim në formacione luftarake dhe burgosem në... me 27 janar 1997.

**Anita Susuri:** Ku ju kanë burgosë? Në shtëpi?

**Enver Dugolli:** Në shtëpi, në shtëpi.

**Anita Susuri:** Edhe ju kanë dërgu...?

**Enver Dugolli:** Po fillimisht në Drenas edhe më pastaj në burg të Prishtinës. Në burg të Prishtinës janë kry hetimet, pastaj më kanë dërgu në burg të Lipjanit edhe aty hetime. Derisa më kthejnë prapë në burg të Prishtinës e këtu kryhet gjykimi e prej Prishtine më dërgojnë në burgun e Dubravës edhe aty qëndroj diku dy-tre muaj, '98-tën. Pas epopesë së UÇK-së, pas vrasjes së Adem Jasharit, pas rënies së tij, familjes së tij edhe ngjarjeve që ndodhën në Drenicë diku kah prilli na transferojnë për burgun e Mitrovicës së Sremit. Atje më mbajnë s'bashku me ni grup shokësh që na kanë dërgu atje për afërsisht ni vit. Edhe kur fillojnë bombardimet na sjellin prapë prej burgut të Sremit, Mitrovicës së Sremit, në burg të Nishit. E tri ditë në burg të Nishit, prej burgut të Nishit në burgun e Dubravës. Domethonë, aty ndodhë ajo masakra e Dubravës në burgun e Dubravës.

### Pjesa e Tretë

**Anita Susuri:** Paraprakisht me u rikthy te disa faza. Në burgun e Prishtinës kur erdhët prapë, çfarë dallimi ka qenë prej asaj kohës të parë që jeni konë?

**Enver Dugolli:** Dallimi ka qenë veç se në burgun e dytë kishte shumë pak shqiptarë, gardianë të burgut, e ishin me shumicë gardianë serbë. Dhe ndoshta ishte, ishte risi vetëm se në dhoma ishin ni kand i ndarë për tualet, që ishte dallim prej burgut të parë që nuk kishte hiç. Ishte veç ajo, nifarë kante, nifarë kofe aty. Ndërsa tjerat, ishte po ai burg i ftoftë, burg gjysëmrrreth, me lagështi, me grila e me plot kujtime të hidhura. S'kishte dallim, domethonë ky ishte ai dallimi.

**Anita Susuri:** E sa i përket presionit edhe dhunës?

**Enver Dugolli:** Natyrisht se në burgun e dytë dhuna ishte krejt tjetër natyre edhe krejt tjera përmasa. Tash kish ardhë momenti, kish ardhë koha se ma nuk gjykoheshe thjeshtë ose nuk ndëshkoheshe thjeshtë për ni veprim që e ke bo, por gjykoheshe edhe pse je shqiptar edhe ndëshkoheshe edhe pse je shqiptar. Gjatë gjithë kohës së burgut të dytë, kjo ka qenë tanë kohën e evidente. Sjellja e gardianëve ka reflektu gjithmonë me ndëshkimin edhe arsyeshmërinë e ndëshkimit vetëm pse je shqiptar.

**Anita Susuri:** Pse ka ndodhë kjo? Ky transferim prej ni burgut në ni burg tjetër? Pse e kanë bo këtë?

**Enver Dugolli:** Këtë e kanë bo për dy arsye. E para arsye osht' se burgjet hetuese janë të karakterit derisa ta merr dënimin. Domethonë, mbajtja në burgje hetuese osht' e parapame vetëm derisa të kryhen hetimet dhe ta merr dënimin dhe pastaj bohet transferimi në burgje ma të mëdha që janë të karakterit për vuajtje të dënimit. Ndërsa, arsyeja e dytë osht' se varësisht prej kapaciteteve të burgjeve edhe planifikimeve që i bojnë ata, për të liru vend apo për të dërgu dikund që ka më pak nifarë

planifikimi që e bëjnë për shpërndarjen e të burgosurve dhe sistematizimin e tyre nëpër vende që konsiderojnë ata që janë ma të sigurta apo me kushte ma të rrepta për mbajtje.

**Anita Susuri:** A ka pasë ndonjë paralajmërim, a keni ditë ju që po e ndrroni burgun?

**Enver Dugolli:** Jo, në asnjë mënyrë, në asnjë mënyrë. Gjithmonë ato ndrrimet e burgjeve apo transferet e burgjeve bohen pa pritë, pa kujtu. Vetëm dhetë minuta para se të largojnë të lajmërojnë, “Boni gjërat gati”, edhe kaq. Kur na thonin t’i bënim gjërat gati e dinim se po ndodh ni transfer, diku po na dërgojnë.

**Anita Susuri:** A keni pasë ndonjëherë ndoshta hamendësim ose ndoshta frikë që kanë me iu likuidu diku ose po iu çojnë diku me ju hupë?

**Enver Dugolli:** Po, patjetër. Kjo ka qenë thashë në burgun e dytë sidomos në periudhën kur filloi lufta në Kosovë, çdo ditë ka qenë e paparashikueshme. Je çu në mëngjes, gjithmonë nuk e ke ditë a do ta mbrrish mbramjen. Osht’ ardhë mbramja nuk e ke ditë a do ta zbardhësh mëngjesin. Gjithmonë ka qenë situatë tejet, tejet e tensionume edhe nën stres dhe e një pasigurie të plotë. Për shkak se lufta kish fillu në Kosovë, egërsia e tyre ndaj nesh shfaqej çdo ditë e me përmasa të pakontrollume nganjëherë. Nganjëherë jo, shpesh herë. Kështu që, pasiguria ka qenë nifarë forme e përditshme, e përditshme ka qenë. Por, vjen nifarë momenti që njeriu edhe mësohet, në thojza, msohet me atë rutinën e jetës. Rutinë e jetës së paparashikume.

**Anita Susuri:** A keni pasë kontakt gjatë kësaj kohe me botën jashtë, me familjen për shembull? Ose a keni ditë diçka për ta? Keni pasë shtypin që ju ka ardhë apo diçka?

**Enver Dugolli:** Jo, derisa ka fillu lufta e haptë në Kosovë, kanë ardhë, kanë ardhë ka ardhë baba i ndjerë, ka ardhë nana, ka ardhë vllai. Nganjëherë në mujt apo në dy mujtë. Por, kur kanë fillu pastaj luftimet ma të hapta e sidomos tani bombardimet e NATO-s, çdo gja osht’ ndërpre. As s’kemi pasë asni kontakt me familje, s’e kemi ditë as ku jonë, as ata s’kanë ditë për ne se ku jemi e çka po ndodhë me ne. Ka pasë vizita të Kryqit të Kuq, të delegatëve të Kryqit të Kuq edhe ato derisa kanë fillu bombardimet. Para bombardimeve edhe ato janë ndërpre. Shtyp nuk kemi pasë fare, me përjashtim kur vinin në vizitë përpara iu thonim që t’na pshtjellnin gjësendet me gazeta edhe bile m’kujtohet që ka qenë nifarë momenti si t’burgosnit i patën qujtë “Flija Press”. Gazetat na vinin, fliat apo pitet të pshtjellta me gazeta, ata nuk kujtoheshin që ne ma shumë ishim të interesum për gazetë sesa për fli apo për ushqim që na sillnin. E i qunin “Flija Press”.

**Anita Susuri:** E në kohën kur fillun bombardimet, thatë më duket, që ju kanë sjellë në burgun e Dubravës?

**Enver Dugolli:** Po, po.

**Anita Susuri:** Po më intereson tash kjo edhe masakra.

**Enver Dugolli:** Po, mënyra kur na thanë që boni gjërat e juja gati prej Mitrovicës së Sremit e dishim që diku po na dërgojnë. Edhe pse të thom që Mitrovica e Sremit osht' storie e veçantë ajo për mënyrën se si janë sjellë ndaj nesh për mënyrën si na kanë trajtu, për torturat që na kanë bo osht' ni storie e veçantë, e për të cilën edhe kam shkru në libër. Por, kur na thanë që po na largojnë prej atyhit, më kujtohet do gjësende që kishim me veti. Se kur shkojsh në pranim të burgut t'i ndalin gjësendet që s'janë të pranueshme, për shembull rripi, najkush kush mbante zinxhirë apo diçka, monedhë, naj çels, nuk lajnë kurgjo. Edhe i len në nifarë ormani.

Mu më mungonte diçka, nuk më kujtohet ni rrip apo diçka edhe me gjasë e kishin marrë e kishin tjetërsu. "Po çka po ju duhet? S'ju duhet", tha, "kurgjo". Me nifarë forme ata... ne nuk dinim gjë. S'dinim asgjë çka po ndodhë me neve, pse po na transferojnë prej burgut të Sremit, por si duket ata e dini. Edhe vet përgjigja që dhanë çka po ju duhet len për të kuptu që diçka e keqe po përgatitet ndaj nesh. Sepse të rrezikosh gjatë bombardimeve me autobusa e të na sjellësh prej Mitrovicës së Sremit që osht' në Vojvodinë atje e rrugës deri në Kosovë, veç ishte ni plan i përgatitun për të cilin ne nuk dinim gjë.

Në burgun e Dubravës, objekti i burgut të Dubravës pasi na kishin transferu para ni viti edhe ata na kishin transferu me arsyetimin se nuk ka kushte sigurie, për çështje sigurie po ju largojmë. E tash na kthenin kur siguria ishte... apsolutisht s'kishte siguri, s'kishte fare, për shkak se lufta kishte eskalu, bombardimet e NATO-s kishin fillu. Nuk na bindte ndërmend edhe s'mund ta konceptonim fare pse na kanë grumbullu e pse po na grumbullojnë aty në burgun e Dubravës. Fillunë pastaj të sillnin edhe të burgosur tjerë nga burgjet e tjera në Kosovë. Fillunë të sjellin edhe qytetarë që i kishin marrë nëpër shtëpitë e tyre, lagjet e tyre, sidomos ata, ni grup i madh prej Gjakovës që i prunën mbi 150 veta.

Ashtu na mbanin, na dërgonin me radhë racionet e ushqimit edhe filloi ni lloj monotonie aty, as nuk ndodhte gjë. Dëgjonim krisma armësh, luftimesh që bëheshin më larg. Tek kur ka fillu, me 19 maj '99 ka fillu, e kanë goditë aeroplanët e kanë goditë ni pavijon. Aeroplanët...

**Anita Susuri:** NATO-s?

**Enver Dugolli:** Po, e kanë goditë. Po, të NATO-s me gjasë se NATO ishte n'atë kohë e mbizotëronte qiellin kudo në Kosovë e Serbi, sepse ishte ofanzivë apo goditje ndëshkuese ndaj agresionit serb edhe masakrave që i bonte. Dhe për ne pastaj ke shumë e habitshme se si shumë shpejt dolën gardianët, dolën gardianët nga godinat e burgut dolën në ambientin e jashtëm... jashta mureve. Ata si duket gjatë kohës që na s'kemi qenë aty, ata e kishin pasë përdorë aty edhe ma vonë mësum se ajo burgu i Dubravës është përdorë si bazë e njësive speciale të policisë serbe edhe të ushtrisë.



Me gjasë ata kanë instaluar edhe farë lokatorësh aty që kanë sinjalizuar që është ende bazë ushtarake policore. Këtu si duket edhe NATO ka ra në grackë të tyre edhe bombardimet që kanë ndodhë edhe me 19 po edhe me 21-tin, dy ditë është si rezultat i asaj se në hartat e NATO-s, në hartat e aleancës ka figurë se Dubrava është bazë ushtarake. Dhe kjo është... ma merr menja kjo është ajo arsyeja pse kanë goditë. Se përndryshe nuk ka asni arsyetim tjetër, asni. Na kemi qenë të burgosur, na s'kemi qenë as të armatosur, as s'kemi qenë njësi...

**Anita Susuri:** E ju po thoni që ndoshta serbët e kanë përdorë si praktikë m'i vra të burgosurit që janë e ata me ikë ma shpejtë?

**Enver Dugolli:** Po, po. Kjo pastaj doli se ata e kanë ditë saktë se NATO do të godet, se këta kanë çu sinjale që është bazë ushtarake. I kanë provoku edhe forcat NATO-s. Na kemi qenë mish për top aty, thjeshtë. Nifare forme na kanë futë në grackë që të vritemi nga avionët e NATO-s dhe këta t'i thojnë botës që NATO po vret të burgosur shqiptarë. Mirëpo, si duket NATO e kuptoi këtë pas 21-tit dhe nuk ka goditë më. Ndoshta edhe falë ni gjindshmërie të burgosurve të cilët me ato plastikat e dritave neon që janë të gjata, plastika të gjata, e shkrujtën, disa djem e shkrujtën në mes të fushës dhe mes pavionëve dhe menzës ku ishte, servohej ushqimi, e shkrujtën, "Help!" në anglisht. Ajo reflektonte shumë nga lartë dhe si duket e kanë pa që diçka nuk është në rregull dhe nuk kanë bombardu ma.

Mirëpo, ata i ndërprejnë bombardimet, NATO-ja. Por, Serbia filloi edhe serbtë, policia, ushtria serbe filloi ta realizoj skenarin dhe filloi të ekzekutoi, na ekzekutoi kështu në mënyrë masovike të burgosurit shqiptarë që ishim aty, që ishim mbi 950 vetë...

**Anita Susuri:** Qysh ka ndodhë kjo? Ky ekzekutim?

**Enver Dugolli:** Po, pas 21 marsit, 21 majit që thashë ndodhi bombardimi i dytë i NATO-s. Të burgosurit që shpëtuan i mblodhëm të plagosurit, por edhe të vdekurit i vendosëm në pjesën veriore që është fusha e sportit. Ish ni vend ma i gjanë aty. Edhe ideja jonë ishte që të rrinim aty, të flenim aty natën për shkak që ende frikësoheshim nga bombardimet e NATO-s. Edhe atë natë ne qëndruam nën qiellin e hapur, domethënë në fushën e sportit. Ndërsa në mëngjes, herët në mëngjes një serb i uniformuar që nuk e di kush ka qenë sepse ishte ma larg edhe ne ishim gati të gjithë në gjumë, na foli me megafon prej karullës [kullë vrojtimi]. Tha, "Për 15 minuta të bëheni gati. Merrni gjërat e juja edhe bëhu rresht këtu", na tregun ku m'u bo, "sepse do t'ju transferojmë prej këtij burgu se s'ka kushte me ju mbajtë këtu".

Ne fillim shpejt t'i marrim ato gjërat që i kishim edhe fillim ta bëjmë atë rreshtin e trashë, rresht i trashë në nifare forme ishim kah katër-pesë në rresht, sepse ish numër i madh. Edhe krejt ashtu përreth gati murit edhe asaj karullës. Në ni moment ni i burgosur më thotë, ni shok i burgut që ishim në Mitrovicë të Sremit, "Bac", po m'thotë se bac më thirrke ni Visar Ballovc, tha, "hajde të bohemi bashkë na të Sremit, na që kemi qenë në burg të Sremit edhe kudo që t'na çojnë prapë jemi bashkë", a

po kupton. Tash mbetëm dy grupe. Ni grup ishim këtu, njo ma knej. Ishim nifarë forme, s'mujshim m'u bo bashkë. Thashë, "Hajde po dalim në fillim të rreshtit. Bëhemi bashkë në fillim të rreshtit edhe kudo që t'na çojnë shkojmë bashkë".

Kemi dalë, kom dalë unë me ni grup tjetër edhe ata ni grup edhe kemi fillu me ecë me dalë në fillim të rreshtit. Ende pa dalë në fillim atje, kanë fillu detonime, kanë fillu me gjujtë bomba edhe kur e kam kthyer kokën me pa, nuk kam mujtë m'i besu syve të mi. Ende po mendoja që jam ndonjë andërr të keqe. Sikur kur të minohet, nëse keni pa najherë nëpër këto dokumentarët qysh e minojnë fushën, e minunë. Ashtu m'u ka dokë që po eksplodon, nga toka po del diçka. Aq shumë kanë gjujtë granata dore prej mureve. Kanë hypë në mure edhe prej karaulle edhe veç kanë gjujtë granata dore.

Për ni moment jam shtangë, thjeshtë, s'kam mujtë me besu. Kur kanë fillu pastaj, që njerëzit të shpërndahen ata kanë fillu me gjujtë me ni arsenal të tanë të armëve që i kanë pasë. Armë, mitroloza, pushkë, snajper gjithçka. Edhe kemi fillu jemi, kond e ka rrokë ka mbetë në vend. Disa që kemi mujtë me ecë, që s'kem pasë naj lëndim kështu apo plagosje kemi ikë në drejtim të kundërt. Edhe e di se aty kanë mbetë diku rreth 60-70 të vrarë, po atë moment kanë mbetë. Bile, më kujtohet në atë vendin ku kemi qenë aty, posa dola me ata nja 13-14 veta që kemi qenë, u plotësu meniherë prej njerëzve aty që ishin edhe kanë qenë do t'ri, kryesisht janë konë të Drenicës gati të gjithë janë vra. Moment shumë i ranë ka qenë, por kaniherë sa banë njeri, nuk banë as guri.

Kemi shku teposhtë. Atëherë kanë fillu të gjujnë me armë ma të sofistikume. Kush e kish fatin e keq e psonte. Me armë e me snajper kanë gjujtë, me armë të gjata. Pastaj, i kemi mbledhë mas dy-tri ore ata që kanë qenë ma të plagosur i kemi tërheq disa edhe i kemi ofru nëpër pavijone t'u mundu m'i dhonë ndihmën e parë. Disa fillunë që të strehoheshin nëpër puseta, puseta që ishin ma të mdhaja, disa kanë qenë të kanalizimit, disa kanë qenë të nxemjeve. Për vend e kishim ma të sigurtë.

Mirëpo, ata kanë vrojtu me dylbi se ku po fshehemi dhe herë pas here hynin, hynin të armatosur, të maskum edhe kështu me nifarë forme [bënin] ekspedita ndëshkuse. Hynin ekzekutonin kond e gjenin rrugës edhe në ato shaktet, qato pusetat, gjunin bomba dore. Kështu që, ka pasë edhe të vramë edhe në ato pustetat, të vramë e të plagosun ka pasë në numër të madh. Kjo ka ndodhë deri me datën 24. Ku me 24, veç na kanë transferu pastaj në burgun e Lipjanit. Me 24 maj.

**Anita Susuri:** E kur ka përfundu lufta, ju keni qenë ende këtu? Në Kosovë keni qenë apo? Qysh ka ndodhë?

**Enver Dugolli:** Po me 9 qershor kur osht' nënshkru marrëveshja e Kumanovës, na nuk kemi ditë që osht' nënshkru. Kur ishim në burgun e Lipjanit, na patën sjellë prej burgut të Dubravës edhe e dëgjum nifarë shfrenimi të madh të gjujtjeve me armë. Ne mendum që ndoshta ka naj luftim aty afër, por si duket ato të shtënat me armë ishin të shtëna kështu nga ngazëllimi që përfundoi lufta apo çka po di une. Na lidhën, erdhën në mbramje na lidhën durtë mrapa me ato, do farë lidhëse të plastikës që të

kpusin durtë krejt. Ato janë shumë të rrezikshme edhe të vështira t'i bajsh ato. Na kanë lanë qashtu të lidhun deri në mëngjes. Në mëngjes na kanë marrë me autobusa.

Nish Ekspres kanë qenë ata autobusa dhe kur pashë Nish Ekspres e dita që po na dërgojnë në burgun e Nishit. Edhe na kanë dërgu. Kur kemi shku te burgu i Nishit, sepse burgun e Nishit tash unë e njifsha, e disha që na futën aty edhe e di që e kam ni ni fjalë prej ni gardianit pyti, "Pse po gjujnë ushtria?" se kaloi ni veturë edhe gjutën me armë. Edhe ai tha, "Janë gzu", tha, "se përfundoi lufta". Edhe aty e morra vesh që ka përfundu lufta. Edhe na futën mrena në dhomë, po ju thom atyne shokve që ishin në dhomë, "Lufta paska përfundu". "Pse ku p'e din?" "Po e nijta kështu kështu..."

Po, lufta kish përfundu, por për neve jo. Për ne të burgosurve shqiptarë, lufta veç vazhdonte edhe ma e ashpër, shumë ma e tmerrshme. Domethonë, ishin tortura e rrahje brutale që vazhdonin çdo ditë. Çdo ditë ndaj nesh. Ishin ekspedita ndëshkuse, a din, kështu të porosituna thjeshtë tash meqë kishin humbë Kosovën. Ni pjesë të Kosovës e kishin te ne dhe shfryheshin ndaj nesh. Ka zgjatë kjo dikund me siguri katër-pesë muj pa ndërpre. Ka pasë, a din, thjeshtë malltretime e tortura të pandërprera.

Shto këtu që ishim edhe në buzë të falimentimit shpirtëror jo, por fizik, për shkak se ushqimet ishin shumë të pakta edhe mungonin. Gjithçka na mungonte. Ishim në ni gjendje shumë të randë fizike, sepse të gjithë kishim hup aq shumë peshë sa nuk e merr me mend që ni... unë kisha pa, domethonë kisha pa fotografi e inxhizime nga lufta në Bosnje që i mbanin të burgosurit në kampe përqendrimi, ashtu ishim bo edhe na. Të malltretum, të torturum, pa bukë, pa ushqim, të keqtrajtum e gjithçka.

**Anita Susuri:** Për lirimimin e juve kanë ndërhy edhe Kryqi i Kuq, nuk e di...

**Enver Dugolli:** Po, kur na kanë liru, domethonë masi fillunë aty në Serbi që e kanë bo atë ligjin për amnesti. Pastaj, të gjitha lëvizjet që janë bo prej burgjeve të Serbisë deri në Kosovë janë bo me transport edhe me përkujdesje të Kryqit të Kuq deri në Kosovë.

**Anita Susuri:** Pas lirimimit, takimi me familjen qysh ka qenë për juve ky përjetim?

**Enver Dugolli:** Po ka qenë tepër moment i pritshëm, po me nifarë forme edhe atëherë nuk kemi ditë shumë të gzohe mi, se ni pjesë pat' mbetë ende në burg. Nuk u lirinë krejt, na ndanë. Disave na lirinë, e disa mbetën në burg. Edhe atë gzim nuk mujtëm me përjetu shkaku i asaj, se ni pjesë e shokëve mbetën në burgje domethonë. Edhe dënimi im e i shumë tjerëve që ndodhi atëherë, 2001-tën, ishte nifarë lirimimi pa mujtë me përjetu tamon atë ndjenjën e gzimit se na u nda përgjysmë. Kështu që, edhe lirimimin e përjetum keq në aspektin emocional. Saqë edhe fillumë, meniherë pas lirimimit fillumë me protesta për m'i liru të tjerët. Na që ishim liru së bashku me familjet e tyne, tantë e njerëzit që na u bashkoheshin e fillum me demonstrata e protesta për t'i liru të tjerët.

**Anita Susuri:** A ka ndodhë pastaj lirimimi i të gjithëve...

**Enver Dugolli:** Deri 2002-ën pastaj janë liru të gjithë.

**Anita Susuri:** Zotni Enver, nëse keni edhe diçka që kishi dashtë me shtu, që mendoni që duhet m'u cekë.

**Enver Dugolli:** Shumë çka ka për m'u cekë po osht' shumë gjatë edhe faleminderit për këtë mundësi. Ndoshta kom lanë edhe shumë çka pa u cekë, se ka edhe hollësi e momente tjera që janë konë me interes për publikun e për njerëzit. Por, besoj që në pika të përgjithshme këto janë.

**Anita Susuri:** Faleminderit shumë!

**Enver Dugolli:** Faleminderit!